




**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0057834/22-9.3 dt. 29.06.2022**  
**Mitrovicë**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 73, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës; nenit 8, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna; në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-7 dt. 31.01.2022 Për themelimin e komiteteve konsultative, pasi shqyrtoj Raportin e Panelit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative Nr. 02-060/01-0024048/22-9 dt. 09.06.2022; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 29.06.2022; sjell këtë:

**VENDIM**

**Për emërimin e anëtarëve të Komitetit konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit**

1. EMËROHEN anëtarët e Komitetit konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në përbërjen si në vijim:
  - 1.1 Alban Sinani,
  - 1.2 Fjolla Salihu,
  - 1.3 Veton Kerveshi,
  - 1.4 Vehbi Goxhuli,
  - 1.5 Arif Kadriu dhe
  - 1.6 Valentina Imeri Jetullahu.
2. Komiteti konsultativ i themeluar me pikën 1 të këtij vendimi, jep propozime nga fushë veprimtaritë e ndryshme në pajtim me Statutin e Komunës:
  - 2.1 Dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme,
  - 2.2 Hulumtime të ndryshme,
  - 2.3 Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse,
  - 2.4 Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës,
  - 2.5 Japin propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuar.
3. Mandati i anëtarëve të komiteteve konsultative është 4 (katër) vjeçar.
4. Komiteti nga radhët e veta zgjedhë Kryesuesin.

5. Komiteti konsultativ obligohet që t'i dorëzojnë raport vjetor për punën e tyre Kuvendit të Komunës.
6. Anëtarët e komiteteve konsultative për punën e tyre kompensohen nga buxheti i Komunës. Shuma e kompensimit është 50 € dhe është e njëjtë me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të paguhet për më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit të Komunës.
8. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**

**Kryesuesja e Kuvendit**



**Vësa BROJA**

**Dorëzohet:**

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të emëruar